



**Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve
ish Republika Jugosllave e Maqedonisë
Zgjedhjet Presidenciale dhe Lokale, Raundi i dytë, 5 prill 2009**

DEKLARATA E REZULTATEVE DHE KONKLUDIMEVE PRELIMINARE

Shkup, 6 prill 2009 – Me ftesë të Ministrisë së punëve të jashtme, Zyra e OSBE-së për institucione demokratike dhe të drejta të njeriut (OSBE/ODIHR) vendosi një Mision për vëzhgimin e zgjedhjeve (MVZ) për të vëzhguar zgjedhjet presidenciale dhe lokale të 22 marsit në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Misioni i OSBE/ODIHR-së për vëzhgimin e zgjedhjeve mbeti në vend që të vëzhgojë edhe raundin e dytë të zgjedhjeve. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (APKE) emëroi një Komision Ad Hoc për vëzhgimin e zgjedhjeve presidenciale dhe emëroi një përfaqësues për të qenë prezent edhe në raundin e dytë të zgjedhjeve.

Raundi i dytë i procesit zgjedhor do të vlerësohet në bazë të përmbushjes së përkushtimeve dhe standardeve të OSBE-së dhe Këshillit të Evropës për zgjedhje demokratike, si dhe të legjislacionit vendor. Kjo deklaratë duhet të konsiderohet së bashku me Deklaratën për konkludime dhe të dhëna preliminare të shpallur më 23 mars, pas rrethit të parë të zgjedhjeve, nga Misioni ndërkombëtar për vëzhgimin e zgjedhjeve i përbërë nga OSBE/ODIHR, Asambleja Parlamentare e OSBE-së, APKE, dhe nga Kongresi i pushteteve lokale dhe rajonale të Këshillit të Evropës. Vlerësimi përfundimtar i zgjedhjeve do të varet, pjesërisht, nga zbatimi i fazave të mbetura të procesit zgjedhor, përfshirë këtu numërimin, përpunimin dhe paraqitjen tabelore të votave dhe shpalljen e rezultateve, zgjidhja e vërejtjeve dhe ankesave të mundshme, dhe zbatimi i raundeve të mundshme shtesë të procesit zgjedhor. OSBE/ODIHR do të shpall raport final gjithëpërfshirës, që do të përfshijë edhe rekomandime për përmirësime potenciale, rreth dy muaj pas kompletimit dhe përfundimit të procesit zgjedhor. Raporti i APKE për zgjedhjet presidenciale do të diskutohet gjatë pjesës të seancës të muajit prill të vitit 2009.

Misioni i OSBE/ODIHR për vëzhgimin e zgjedhjeve dhe delegacioni i APKE dëshiron të falënderoj autoritetet dhe qëndrojnë të gatshëm të vazhdojnë edhe më tej të mbështesin ata dhe shoqërinë civile në vend, në zbatimin e zgjedhjeve demokratike.

KONKLUDIMET PRELIMINARE

Raundi i dytë i zgjedhjeve presidenciale dhe lokale më 5 prill 2009 përmbushi të shumtën e përkushtimeve dhe standardeve të OSBE-së dhe Këshillit të Evropës për zgjedhje demokratike megjithëse disa nga çështjet e identifikuar në raundin e parë, duke përfshirë edhe njoftime të besueshme për frikësime, rritën shqetësimet. Dita e zgjedhjeve ishte përsëri e qetë dhe pati përmirësime të mëtjetshme në zbatimin e votimit dhe numërimit.

Në fushatën për raundin e dytë, shumica e kandidatëve dhe partive politike shprehën përkushtimin e tyre për të siguruar zgjedhje të qeta dhe demokratike. Aktivitetet politike ishin kryesisht në nivel të ulët me relativisht pak evenimente. Liria e shprehjes dhe liria e grumbullimit ishte kryesisht e respektuar. Kandidatët dukej të përdornin gjuhë të moderuar në deklaratat e tyre publike. Mirëpo, situata ishte e tensionuar në shumë komuna ku kishte garë të ngushtë për kryetar komune.

MVZ i OSBE/ODIHR pranoi një numër të madh të raporteve brengosëse dhe të besueshme për presionin mbi, ose frikësimin e qytetarëve midis dy raundeve të zgjedhjeve, që seriozisht devijoi

nga cilësia e përgjithshme e procesit zgjedhor. Pothuajse të gjitha këto ankesa dhe pohime kishin të bëjnë me aksionet e funksionarëve shtetëror dhe aktivistëve të partisë politike në qeveri. Përpjekjet nga autoritetet që t'i zgjidhin këto probleme nuk ishin të mjaftueshme që tu japin fund të njëjtave ose që të rikthejnë besimin.

Disa aspekte pozitive të procesit zgjedhor të cilat u paraqitën midis dy raundeve përfshijnë:

- Shumica e garuesve janë dakord se raundi i parë i zgjedhjeve ishte kryesisht mirë i zbatuar dhe i pranuar rezultatet;
- Komisioni shtetëror zgjedhor (KShZ) shpalli rezultatet e detajuara zgjedhore në veb-faqen e tyre, deri në nivel të vendvotimit, një ditë pas raundit të parë të zgjedhjeve;
- KShZ-ja ndërmoi hapa për të zgjidhur disa parregullsi që u vunë re gjatë raundit të parë të votimeve, duke miratuar udhëzime të shkurtra, praktike për punën e Komisioneve zgjedhore komunale (KZK) dhe Këshillave zgjedhor (KZ), me fokusim në parandalimin e votimit familjar, dhe me mbajtjen e trajnimeve shtesë;
- Mediat, marrë si tërësi, siguruan mbulim të shumëllojshëm të zgjedhjeve presidenciale dhe lokale, edhe pse në shkallë më të ulët sesa para raundit të parë, si reflektim i nivelit më të ulët të aktiviteteve të fushatës zgjedhore. Kishte vetëm një debat televiziv midis kandidatëve presidencial, si dhe një sërë debatesh mes kandidatëve për kryetarë të komunave;
- Shoqëria civile përsëri dërgoi në teren një numër të madh të vëzhguesve jopartiak nga vendi;
- Prania e kufizuar, por e dukshme, e policisë kontribuoi në ruajtjen e një atmosfere të qetë në ditën e zgjedhjeve.

Megjithatë, janë vërejtur parregullsi shtesë, edhe atë si vijon:

- Kushti i daljes në votim prej 40 për qind në raundin e dytë vazhdon të krijon mundësinë për dështimin e zgjedhjeve në të ardhmen;
- KShZ-ja nuk u morr me ankesat lidhur me raundin e parë të votimit brenda afateve ligjore, duke vonuar rezultatet përfundimtare dhe duke ndërlikuar përgatitjet për raundin e dytë. Vendimet e KShZ-së për ankesat jo gjithnjë dukeshin të jenë konzistente;
- Midis dy raundeve KShZ-ja jo gjithmonë veprroi në të njëjtën frymë të konsensusit siç ishte para raundit të parë, dhe solli vendime për një numër të çështjeve në lidhje me votat, që dukeshin sikur po reflektojnë interesat e partive politike;
- Mbeten bregat lidhur me saktësinë e listës së votuesve, në veçanti lidhur me numrin e madh të qytetarëve që ndodhen jashtë shtetit;
- Sesionet e Gjykatës Administrative për proceset gjyqësore lidhur me zgjedhjet mbeten të mbyllura për publikun përveç gjatë shpalljes së përmbajtjes së padisë gjyqësore, përkundër kërkesave në Kodin zgjedhor që të këto vendime të sillen në sesione publike.

Dita e votimit kaloi kryesisht në mënyrë paqësore dhe të qetë, pa raste dhune ose incidente të mëdha. KShZ-ja vlerësoi jehonën e votuesve në rreth 42 për qind. Në përgjithësi vëzhguesit e OSBE/ODIHR dhe APKE dhanë vlerësim pozitiv për procesin e votimit në 97 përqind të vendvotimeve të vizituara, pa ndonjë dallim të dukshëm nga aspekti rajonal. Vëzhguesit raportuan për më pak shkelje procedurale sesa në raundin e parë dhe vetëm disa raste të izoluara të shkeljeve serioze. Votimi familjar u vërejt në 13 për qind të vendvotimeve të vizituara, akoma një numër i lartë por dukshëm i reduktuar sesa në raundin e parë. Numërimi i votave u vlerësua pozitivisht, me disa përjashtime, megjithëse kishte disa parregullsi procedurale. Performanca e KZK-ve në përgjithësi u vlerësua pozitivisht. KShZ-ja përsëri publikoi rezultatet preliminare sipas vendvotimeve në veb-faqen e tij natën e zgjedhjeve.

TË DHËNAT PRELIMINARE

Historiat

Sipas Kodit zgjedhor, raundi i dytë i zgjedhjeve për president dhe kryetarë të komunave duhet të mbahet brenda dy javëve nëse asnjëri prej kandidatëve nuk merr shumicën e mjaftueshme të votave në raundin e parë. Për zgjedhjet presidenciale, kandidati i cili fiton shumicën e votave në raundin e dytë zgjidhet, nëse së paku 40 përqind i zgjedhësve të regjistruar dalin në balotazh. Në të kundërtën, i gjithë procesi zgjedhor duhet të përsëritet. Nuk ka kusht për dalje në raundin e dytë për kryetar komune.

Komisioni shtetëror zgjedhor (KShZ) nuk shpalli rezultatet e plota preliminare nga raundi i parë brenda afatit shumë të shkurtër ligjor të caktuar nga Kodi zgjedhor (Neni 135.1). Ai në vend të kësaj vendosi të presë deri në përfundim të procesit të vërejtjeve dhe ankesave që të shpallë rezultatet përfundimtare, të cilat për shkak të vonesës u publikuan më 3 prill. Sidoqoftë, KShZ-ja shpalli rezultatet paraprake zgjedhore në veb-faqen e tij, deri në nivel të vendvotimit, më 23 mars, një ditë pas zgjedhjeve.

Në raundin e parë të zgjedhjeve presidenciale, Gjorge Ivanov, kandidati i Organizatës së Brendshme Revolucionare të Maqedonisë – Partia Demokratike për Bashkim Nacional të Maqedonisë (VMRO–DPMNE), dhe Ljubomir Frçkoski, kandidati i Lidhjes Social Demokratike të Maqedonisë (SDSM), fituan numrin më të madh të votave – 33.95 dhe 19.81 përqind – dhe andaj garuan në raundin e dytë. Tridhjetë e tre kandidatë për kryetarë të komunave ishin zgjedhur në raundin e parë më 22 mars, ku VMRO-DPMNE ka fituar në 23 komuna, SDSM në katër, Bashkimi Demokratik për Integrim, partia e shqiptarëve etnik (BDI) në katër komuna, dhe Partia Demokratike e Turqve dhe Lëvizja për Bashkimin Kombëtar të Turqve – nga një secila. Në 43 komuna dhe në qytetin e Shkupit, raundi i dytë i votimeve u mbajt më 5 prill sepse kandidatët nuk fituan shumicën e nevojshme në raundin e parë. Dalja në votime në raundin e parë ishte rreth 57 përqind. Rezultatet e raundit të parë ishin kryesisht të pranuar nga garuesit.

Për më tepër, raundi i parë i zgjedhjeve për kryetar komune dhe/ose zgjedhjeve lokale u mbajt në 5 prill në 124 vendvotime në pjesë të ndryshme të vendit. Këto 118 vendvotime nuk u hapën në 22 mars për shkak të borës së madhe dhe 6 u anuluan gjatë procesit të ankesave. Sipas KShZ-së, numri i votuesve të regjistruar në këto vendvotime nuk ishte i mjaftueshëm që të ndikojë në rezultatet e zgjedhjeve presidenciale, por do të kishte ndikuar rezultatet për zgjedhjen e kryetarëve të komunave në tetë komuna dhe rezultatet e këshillave komunale në 23 komuna. Prandaj, në 5 prill u mbajt raundi i parë në këto vendvotime në të njëjtën kohë me raundin e dytë presidencial.

Administrata zgjedhore

Midis dy raundeve, KShZ-ja ndërmori disa përpjekje që të zgjidh problemet dhe parregullsitë procedurale të vërejtura në nivel të Komisioneve zgjedhore komunale (KZK) dhe Këshillave zgjedhore (KZ) gjatë raundit të parë. Në veçanti, KShZ-ja lëshoi disa udhëzime të shkurtra, praktike për punën e KZK-ve dhe KZ-ve në ditën e votimit, të cilat përmbanin udhëzime të rrepta për parandalimin e votimit familjar dhe votimit në emër të dikujt tjetër. KShZ-ja gjithashtu zbatoi disa trajnime shpesh për KZK-të, dhe KZK-të më pas organizuan disa trajnime për KZ-të. Këto hapa kishin për qëllim të evitojnë vështirësitë e raundit të parë të cilat kryesisht buronin nga trajnimi joadekuat, rregullave të pamjaftueshme dhe mungesës së detajeve të sakta dhe precize në Kodin zgjedhor dhe në Doracakun e KShZ-së për edukimin e organeve zgjedhore.

KShZ-ja përfundoi të gjitha përgatitjet teknike për raundin e dytë brenda afateve kohore të parashikuara, edhe pse në disa raste pa i ndjekur procedurat e nevojshme. Për shembull, KShZ-ja formalisht vendosi për dizajnin dhe tiparet e fletëvotimeve për raundin e dytë vonë, më 30 mars. Sidoqoftë, MVZ i OSBE/ODIHR vërejti se fletëvotimet veç më kishin filluar të shtypeshin më 28 mars.

Kryesisht fokusi i KShZ-së midis dy raundeve zgjedhore përqëndrohej në zgjidhjen e ankesave zgjedhore (shih pjesën për Ankesat dhe Vërejtjet, më poshtë). KShZ-ja nuk kishte mundësi të merret me numrin e madh të ankesave brenda afateve të kërkuara, duke vonuar kështu finalizimin e rezultateve dhe përgatitjet teknike për raundin e dytë. Në punën e saj, KShZ-ja jo gjithmonë vepronte në frymë të njëjtë të kolegjalitetit dhe konsensusit siç ndodhi para raundit të parë. Shumica e vendimeve u morën me vota të ndara, e cila ndonjëherë dukej sikur pasqyronte interesat partiake. KShZ-ja nuk u morr me ankesat e partive më të vogla politike të cilat nuk kanë anëtarë të emërtuar në KShZ.

Brengat lidhur me saktësinë e listës së votuesve ishin të theksuara në raundin e dytë, në veçanti lidhur me numrin e madh të raportuar të qytetarëve që jetojnë jashtë shtetit, emrat e të cilëve mbeten në listën e votuesve. Shumë bashkëbisedues shprehën brengat e tyre se kjo mund të paraqesë mundësi për manipulim, në veçanti me qëllim që të arrihet dalja e nevojshme në votim prej 40 përqind në raundin e dytë që zgjedhjet presidenciale të jenë të vlefshme. Gjatë raundit të parë të votimit, vëzhguesit e MVZ-së vërejtën një sërë nënshkrimesh që dukeshin identike në 19 vendvotime gjatë procesit të votimit, dhe në katër gjatë numërimit të votave. Në raundin e dytë, vëzhguesit e MVZ të OSBE/ODIHR vërejtën një rast të tillë.

Ambienti gjatë fushatës

Aktivitetet e fushatës zgjedhore të shumë garuesve midis dy raundeve ishin në nivel të ulët, me një numër më të vogël të evenimenteve publike dhe pa asnjë miting të madh që karakterizoi raundin e parë. Partitë politike dhe kandidatët për kryetar komunash u koncentruan në aktivitete me profil më të ulët siç është fushata prej dere në derë. Partia në qeveri, VMRO-DPMNE, ishte deri në një masë të caktuar përjashtim nga ky trend në fushatën e tyre për kryetar komune, ngase zyrtarë të lartë dhe ministra të kabinetit vizituan disa pjesë të vendit që të mbështesin kandidatët e tyre partiak. Për dallim nga partitë e tjera, panele të reja reklamimi të VMRO-DPMNE-së u paraqitën në kryeqytet pas raundit të parë, duke paraqitur Kryeministrin me kandidatët për kryetarë të komunave.

Garrat dhe çështjet komunale vazhduan të dominojnë në agjendën e fushatës dhe madje rritën profilin e tyre. Me më pak zgjedhje para tyre, partitë politike fokusuan përpjekjet e tyre në mënyrë më strategjike në komuna ku rezultatet ishin më të përafërta. Në disa raste, fokusimi dukej sikur ishte i barabartë me presionin e aktivistëve partiak që “të livrojnë votën” e fshatrave dhe vendbanimeve të caktuara.

Midis dy raundeve, shumica e kandidatëve dhe liderëve të partive politike shprehën përbetimin dhe përkushtimin e tyre të vazhdueshëm publik për të siguruar një fushatë të qetë dhe pa incidente. Nuk kishte raste serioze të dhunës lidhur drejtpërsëdrejti me zgjedhjet. Megjithatë, incidente të tjera, përfshirë përlëshjen e demonstruesve në sheshin qendror në Shkup lidhur me planet për ndërtimin e kishës, dhe përlëshjet midis nxënësve të grupeve të ndryshme etnike në një shkollë në Strugë, kishin jehonë të madhe në media dhe u paraqitën si çështje ballafaqimi midis kandidatëve dhe partive në nivel nacional. Edhe pse kishte përpjekje që fushata të mbahet e qetë, tensionet ishin mjaft të larta në disa komuna me gara të ngushta midis kundërkandidatëve, si për shembull në Strugë, Ohër, Demir Hisar, Makedonski Brod, Gostivar, Berovë dhe Petrovec.

MVZ i OSBE/ODIHR-së pranoi një numër të madh të raporteve brengosëse për presion dhe frikësim të qytetarëve lidhur me garat e ngushta zgjedhore në shumë pjesë të vendit. Shumica dërmuese e këtyre pohimeve ishte e drejtuar për funksionarët shtetëror dhe aktivistët e partive politike të partisë në qeveri. MVZ i OSBE/ODIHR ndoqi raportimet e tilla dhe konkludoi që shumica e tyre ishin të besueshme. Të punësuarit në sektorin publik dukeshin sikur janë në veçanti të ndjeshëm ndaj kërcënimeve se vendi i tyre i punës do të rrezikohej nëse ata nuk do ta kishin mbështetur partinë në qeveri; pohimet e tilla ishin të lidhura me politizimin e shërbimeve publike. Disa pohime tjera të shpeshta përfshijnë kërcënime se shërbimet sociale ose pensionet do t'ju ndalen atyre të cilët nuk mbështesin partinë në qeveri dhe se bizneset do t'u nënshtrohen kontroleve tatimore nëse pronarët e tyre nuk mbështesin partinë. Këto ankesa të vazhdueshme kontribuan në mungesën e vazhdueshme të besimit midis shumicës së qytetarëve se ata do të mund të votojnë në mënyrë të lirë dhe pa frikë nga hakmarrja. Edhe pse Kryeministri foli publikisht kundër presioneve dhe frikësimeve, përpjekjet e tij nuk ishin të mjaftueshme që t'i japin fund kësaj ose të rikthejnë besimin publik.

Ministria e punëve të brendshme raportoi se është duke hetuar tre raste të lidhura me pohime për frikësim midis dy raundeve, përfshirë edhe raportimin se njësitë speciale mobile të policisë u janë kërcënuar fshatarëve në komunën Petrovec. Gjithsesi, kishte edhe pohime të besueshme për policinë se ka pasur rol aktiv në mbështetjen e fushatës për partinë qeveritare, për shembull, në Shtip dhe Demir Hisar. Plani për shpërndarjen e policisë në raundin e dytë ishte i bazuar dhe i ngjashëm me planin që me sukses u zbatua në raundin e parë.

Mediat

Kryesisht mediat siguruan mbulim të ndryshëm për zgjedhjet presidenciale dhe komunale. Gjithsesi, duke pasqyruar nivelin e ulët të aktiviteteve të fushatës zgjedhore gjatë raundit të dytë, ky mbulim ishte më pak intenziv se sa në periudhën e fushatës para raundit të parë. Spotet nga fushata me pagesë në media ishin të rrallë mes dy raundeve. Mediat kombëtare mbulonin aktivitetet e fushatave kryesisht në edicionet e tyre të lajmeve. Midis dy raundeve, një debat televizive midis kandidatëve presidencial u emitua dy herë në MTV1. Tre stacione televizive kombëtare dhe disa stacione televizive lokale organizuan debate midis kandidatëve për kryetarë të komunave. Sidoqoftë, një numër i mediave tjera dështuan në organizimin e debateve për shkak se kandidatët refuzuan të participojnë në to.

Përderisa rregullat e Këshillit për radiodifuzion (KR) për mbulimin e fushatës zgjedhore nuk specifikojnë si duhet të shpërndahet emetimi informativ midis kandidatëve në raundin e dytë, KR informoi MVZ-në e OSBE/ODIHR se mediat duhet të respektojnë parimin e barabarësisë. KR shpalli rezultate preliminare nga monitorimi i tyre i mediave për mbulimin e kandidatëve nga raundi i parë, të cilat në përgjithësi ishin në linjë dhe të ngjashme me konkludimet dhe të dhënat e MVZ-së nga monitorimi i mediave.

Shumica e mediave të monitoruara nga MVZ i OSBE/ODIHR, pjesën më të madhe të lajmeve të tyre ia kushtuan VMRO-DPMNE-së dhe LSDM-së, që kishin numër më të madh të kandidatëve në raundin e dytë se sa partitë e tjera. Sidoqoftë, tendenca e disa mediave për t'u fokusuar në këto dy parti rezultoi në disi mbulim të kufizuar të garuesve të tjerë, për shembull të BDI-së.

Në mbulimin e tij të lajmeve për aktivitetet e kandidatëve, partive dhe aktorëve të tjerë politik, kanali publik televiziv MTV-1 i kushtoi 37 për qind të kohës VMRO-DPMNE-së dhe 22 për qind SDSM-së. Televizioni publik kanali MTV-2, i cili emiton kryesisht në gjuhën shqipe, iu kushtoi 26 për qind të mbulimit të tyre të lajmeve për BDI-në dhe 12 për qind për SDSM-në dhe 11 për qind për VMRO-DPMNE-në. Të gjitha televizionet private ju dedikuan pjesën më të madhe të tyre VMRO-

DPMNE-së ose SDSM-së. Kryesisht, shpërndarja e programit për informim midis të gjitha partive dhe kandidatëve ka qenë relativisht e balancuar në TV ALSAT dhe në A1, edhe pse kjo e dyta tregoi anësim në favor të Partisë për Ardhmëri Evropiane (PEI) në garën për kandidat për kryetar të komunës Strugë.

Kandidati presidencial i SDSM-së kishte më shumë mbulim se sa kundërshtari i tij nga VMRO–DPMNE në pothuajse të gjitha mediat e monitoruara, kryesisht për shkak të fushatës më pak të dukshme të kandidatit të VMRO–DPMNE-së.

Ankesat dhe vërejtjet

Procedurat për kundërvajtje të iniciuara nga KShZ dhe nga Këshillit Radiodifuziv para gjykatave kompetente lidhur me fushatat zgjedhore para fillimit zyrtar të fushatës së raundit të parë nuk ishin të kompletuara para raundit të dytë të zgjedhjeve. Shumica e seancave gjyqësore anuloheshin vazhdimisht, që rezultoi me vonesa të mëtejshme në zbatimin e rregullave zgjedhore dhe me mos sigurimin e masave efektive ligjore për të akuzuarit. Midis dy raundeve, KR inicoi procedura shtesë për kundërvajtje.

Në 22 mars, ditën zgjedhore të raundit të parë, KShZ-ja pranoi katër ankesa të dorëzuara nga votuesit në lidhje me të drejtën e tyre për të votuar, të gjitha këto u zgjidhën brenda afateve ligjore. Pas ditës së votimeve, KShZ-ja pranoi 82 ankesa nga paraqitësit e listave lidhur me raundin e parë. KShZ-ja nuk i zgjidhi të gjitha ankesat brenda afatit ligjor. Vendimarrja e KShZ-së për ankesat vazhdoi deri më 30 mars; prandaj edhe Gjykata Administrative nuk ka vendosur përfundimisht për vërejtjet mbi vendimet e KShZ-së deri më 1 prill.

Të gjitha sesionet formale të KShZ-së ishin të hapura për publikun dhe përfaqësuesit e autorizuar të dorëzuesve të listave kishin mundësi të marrin pjesë në rastet e tyre. KShZ nuk kontrolloi të gjithë materialin zgjedhor nga vendvotimet e përmendura në ankesa, dhe në vend të kësaj bazoi vendimet e tij kryesisht në procesverbalet e KZ-ve. Në disa raste, KShZ kërkoi që i tërë materiali zgjedhor të silltet në Shkup dhe të kontrollohet, përfshirë këtu edhe fletëvotimet. Duket sikur KShZ interpretoi në mënyrë të kufizuar obligimet e tij ligjore për zgjidhjen e ankesave në bazë të kontrollimit të materialit zgjedhor (Neni 31.2.35 nga Kodi zgjedhor). Në shumicën e rasteve KShZ-ja morri vendim që nuk duhej të pranonte ankesë nëse në procesverbalin e KZ-së nuk kishte të shkruar vërejtje nga person i autorizuar partiak, edhe pse nuk ka kërkesë ligjore për një gjë të tillë.

Ekzistonin edhe disa pabarazi në vendimet e KShZ-së mbi atë se a duhej të kontrollohej i tërë materiali zgjedhor ose jo. Për shembull, tre vendvotime në komunën Dollneni u anuluan më 28 mars, pasi që KShZ-ja përsëri numëroi fletëvotimet në këto vendvotime për kryetar të komunës dhe vërtetoi se numri i fletëvotimeve tejkalon numrin e nënshkrimeve prej listës së votuesve. Sidoqoftë, KShZ-ja shqyrtoi procesverbalet e rezultateve për Këshillin zgjedhor por votoi – mbi baza partiake – kundër kryerjes së rinumërimit dhe kundër anulimit, edhe pse u verifikua i njëjti dallim mes fletëvotimeve dhe nënshkrimeve si edhe te kandidatët për kryetar komune.

KShZ-ja refuzoi ankesën nga Partia për emancipimin e plotë të Romëve, logoja e të cilëve në fletëvotimet për këshilltarë në katër komuna ishte me gabim e zëvendësuar me logon e një partie tjetër rome, duke thënë se shtëpia botuese kishte bërë gabimin. Gjithsesi, në bazë të Kodit zgjedhor KShZ-ja është përgjegjëse për konfirmimin e dukjes përfundimtare të fletëvotimeve.

KShZ-ja pranoi si me bazë vetëm tetë prej 82 ankesave të dorëzuara (një e dorëzuar nga BDI, tre nga VMRO-DPMNE dhe katër nga SDSM), gjashtë prej të cilave rezultuan me anulimin e rezultateve në vendvotimet për zgjedhje lokale. Njëra prej ankesave të pranuar si me bazë nga

KShZ-ja kishte të bëjë me rinumërimin e fletëvotimeve në 19 vendvotime në Tetovë, ku ishin bërë korigjime joligjore të procesverbaleve të KZ. Si rezultat i rinumërimit, u ndryshua marrja e mandateve në këshillin komunal në Tetovë.

Gjykata Administrative pranoi 52 padi gjyqësore kundër vendimeve të KShZ-së. Përkundër kërkesave ligjore që të vendosë në sesione publike (Neni 150.1 prej Kodit zgjedhor), sesionet e Gjykatës ishin të hapura për publikun vetëm gjatë shpalljes së përmbajtjes së ankesës (padisë). Kontrollimi i materialeve zgjedhore, debatimi dhe vendimarrja e ankesave nuk ndodhi në mënyrë publike. Gjykata publikoi vendimet e saj në veb-faqe. Të gjitha 52 ankesat ishin refuzuar.

Pjesëmarrja e komuniteteve joshumicë

Prej 33 kandidatëve për kryetarë të komunave prej komuniteteve më të vogla etnike, dy fituan në raundin e parë; shtatë kandidatë të tjerë kanë vazhduar në raundin e dytë. Ata kryesisht u takojnë partive që përfaqësojnë grupet e tyre përkatëse etnike. Sidoqoftë, në disa komuna, kandidatë për kryetar komune kanë tentuar që të krijojnë aleanca mes grupeve të ndryshme etnike para raundit të dytë. Në komunën Shuto Orizare, ku që të dy garuesit në raundin e dytë i takojnë grupit të njëjtë etnik, fushata midis dy raundeve ishte e shënuar me tensione të larta, dhe së paku në një rast policia morri në biseda aktivistët partiak lidhur me ankesat për blerje të votave. MVZ i OSBE/ODIHR dëgjoi pohime për blerje votash në komunitetin etnik Rom por nuk ishte dëshmitar i rasteve të tilla.

Pjesëmarrja e femrave

Kandidati presidencial i vetëm femër nuk kaloi në raundin e dytë. Si shtesë, asnjë prej 13 kandidatëve femra për kryetar komune nuk ka fituar në raundin e parë ose e as që ka kaluar në raundin e dytë. Si pasojë e kësaj nuk do të ketë asnjë femër si kryetar komunë; edhe në zgjedhjet lokale të vitit 2000 edhe të vitit 2005, tre femra ishin zgjedhur për kryetar të komunave. Si edhe para raundit të parë, çështjet me interes të veçantë të femrave nuk u prezantuan si duhet as gjatë fushatës e as në media.

Disa bashkëbisedues, përfshirë këtu edhe partitë politike edhe shoqërisë civile, informuan MVZ-në e OSBE/ODIHR-së se ishin ushtruar forma të ndryshme të presioneve mbi disa femra kandidate për këshilltare të komunave, përfshirë në veçanti femra më pak të edukuara nga komunitetet joshumicë, që të heqin dorë nga mandatet në favor të kandidatëve meshkuj.

Vëzhguesit nga vendi

Si edhe në raundin e parë, numri më i madh i vëzhguesve jo-partiak ishte MOST, i cili deklaroi se ka shpërndarë 3.750 vëzhgues për raundin e dytë të votimeve. MOST përsëri zbatoi një numërim paralel të votave për zgjedhjet presidenciale dhe për zgjedhjen e kryetarit të qytetit të Shkupit. Në 5 prill, vëzhguesit jo-partiak nga vendi ishin prezent në 76 për qind të vendvotimeve të vizituara nga vëzhguesit e OSBE/ODIHR dhe të APKE-së. Veç kësaj, partitë politike dhe kandidatët dërguan përfaqësuesit e tyre të autorizuar, që ishin prezent në 93 për qind të vendvotimeve të vizituara në ditën e zgjedhjeve.

Dita e zgjedhjeve

Ashtu siç ishte rasti edhe në raundin e parë të votimit, dita e zgjedhjeve ishte kryesisht e qetë, me rend dhe paqësore, dhe kishte shumë pak raste të problemeve më serioze që u vërejtën. Në të

shumtën e rasteve, vlerësimi i vëzhguesve të OSBE/ODIHR dhe APKE ishte më pozitiv se në raundin e parë. Numrat preliminar të shpallura nga KShZ japin një numër prej rreth 42 për qind të jehonës së votuesve. Sipas të dhënave preliminare të KShZ-së, mbi pesë për qind të votave në zgjedhjet presidenciale kanë qenë të pavlefshme. KShZ filloi të shpall rezultatet dhe t'i vendos në veb-faqe për zgjedhjet presidenciale dhe lokale, gjatë natës të zgjedhjeve dhe atë deri në nivel të vendvotimeve. Hapja e vendvotimeve është vlerësuar pozitivisht nga shumica e vëzhguesve, megjithëse disa probleme përsëri janë vërejtur sa i përket regjistrimit të numrave serik të vulave (për plumbim) të kutive të votimit.

Procesi i votimit është vlerësuar si i mirë ose shumë i mirë në 97 për qind të vendvotimeve të vizituara – një përmirësim nga raundi i parë – dhe përshkruhet si kryesisht mirë i organizuar, i qetë dhe në rregull. Nuk kishte dallime të konsiderueshme në vlerësim nga aspekti rajonal. Ashtu si në raundin e parë, nuk u raportuan raste dhune apo incidente më të mëdha, por tensionimet ishin të qarta në disa vende, veçanërisht aty ku gara mes kandidatëve për kryetar komune ishte shumë e ngushtë. Kishte njoftime për një numër mjaft më të madh të votuesve në shtëpi që kanë votuar një ditë para zgjedhjeve në raundin e dytë. Policia ishte kryesisht mirë e organizuar dhe diskrete.

Përkundër vlerësimit të përgjithshëm pozitiv, u vërejtën disa shkelje procedurale, megjithëse në një shkallë të ulët në krahasim me 22 marsin. Raste të votimit familjar u vërejtën në 13 për qind të vendvotimeve, që është përqindje e lartë por më e ulët se ajo nga dy javë më parë. Votimi familjar ishte përsëri më i përhapur në vendbanimet etnike Shqiptare (23 për qind, krahasuar me 7 për qind në pjesën tjetër të vendit). Dy raste të mbushjes të kutive, në Gostivar dhe në Sopishte u vëzhguan. Probleme të tjera ishin: një person që u "ndihmon" disa personave (16 raste), përpjekje për të ndikuar mbi votuesit (15 raste), votim për tjetër njeri (12 raste), frikësim i punonjësve zgjedhor ose votuesve (tre raste), votim i disahershëm (tri raste). Në 3 për qind të vendvotimeve të vizituara, kutitë e votimit nuk ishin të vulosura në mënyrën e duhur. Në 6 për qind, fshehtësia e votës nuk u sigurua, për shkak të renditjes së dobët apo mungesës së hapësirës në vendvotim, dhe dy raste të njerëzve që kanë fotografuar fletëvotimin e shënuar. Jo gjithmonë përcillej procedura e spërkatjes të gishtit me ngjyrë. Në më pak se 1 për qind të vendvotimeve është vërejtur prania e personave të pautorizuar, dhe vetëm një rast ku një person i tillë është përzier në proces.

Numërimi i votave është vlerësuar pozitivisht në të shumtën e vendvotimeve ku është vëzhguar. Megjithatë, ashtu si dhe në raundin e parë, vëzhguesit e OSBE/ODIHR raportuan se procedurat bazë nuk janë respektuar gjithmonë, veçanërisht para hapjes të kutive të votimit. Kishte dy raste të parregullsive më serioze. Në më se gjysmën e vendvotimeve ku u vëzhgua numërimi, KZ nuk nxori kopje të procesverbaleve që të njoftonte publikun.

OSBE/ODIHR vëzhguan një pjesë të procesit të paraqitjes tabelore në 47 nga 84 KZK, duke e vlerësuar pozitivisht në të gjitha, me përjashtim të një KZK (Tetovë). Ashtu si në raundin e parë, disa probleme me transparencën u vërejtën, veçanërisht sa i përket mundësimin të vëzhguesve të përcjellin regjistrimin e rezultateve.

***Kjo deklaratë është gjithashtu në dispozicion në gjuhën maqedonase dhe shqipe.
Sidoqftë, versioni në gjuhën angleze mbetet dokumenti i vetëm zyrtar.***

INFORMATATA & LAJMËRIME TË MISIIONIT

Misioni i OSBE/ODIHR-së për vëzhgimin e zgjedhjeve (MVZ) u hap në Shkup më 13 shkurt me 39 ekspertë dhe vëzhgues afatgjatë të vendosur në Shkup dhe në 11 qendra rajonale. Për raundin e dytë parë të zgjedhjeve më 22 mars, Asambleja Parlamentare e OSBE-së, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (APKE), dhe Kongresi i

autoriteteve Lokale dhe Rajonale i Këshillit të Evropës iu bashkëngjitën Misionit Ndërkombëtar për Vëzhgimin e Zgjedhjeve. Për raundin e dytë, MVZ i OSBE/ODIHR-së shpërndau 132 vëzhgues afatshkurtër. MVZ i OSBE/ODIHR vëzhgoi zgjedhjet në më se 750 vendvotime prej gjithsej 2.976 vendvotimeve dhe numërimin në rreth 61 vendvotime. MVZ i OSBE/ODIHR gjithashtu monitoroi performancën në 39 KZK. Z. Pitër Ajker është Shef i Misionit për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ) të OSBE/ODIHR.

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (APKE) zbatoi një vizitë parazgjedhore prej 26-27 shkurt 2009. Për raundin e parë të zgjedhjeve APKE caktoi një Komision Ad Hoc që përbëhej prej 14 anëtarëve. Për raundin e dytë të zgjedhjeve APKE ishte e prezantuar nga Z-ri Jørgen Poulsen, anëtar i Asamblesë.

MVZ i OSBE/ODIHR dhe APKE dëshiron të falënderojë autoritetet e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë për ftesën për të vëzhguar zgjedhjet, Komisionit shtetëror zgjedhor për bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe për mundësimin e dokumenteve të akreditimit, dhe Ministrinë e punëve të jashtme dhe organet tjera shtetërore dhe komunale për ndihmën dhe bashkëpunimin e tyre. MVZ i OSBE/ODIHR dhe APKE gjithashtu dëshirojnë të shprehin falënderimin e tyre ndaj Misionit për Monitorim të OSBE-së në Shkup dhe institucioneve të tjera ndërkombëtare për bashkëpunimin dhe mbështetjen e tyre.

Për më shumë informata, ju lutemi kontaktoni:

- Z. Pitër Ajker, Shef i MVZ të OSBE/ODIHR, në Shkup (+389–2–320 4777);
- Tomas Rajmër, OSBE/ODIHR, celular: (+48 609 522266); ose Z. Dru Hajsllop, OSBE/ODIHR Këshilltar për zgjedhje, në Varshavë (+48–22–520 0600);
- Artjemi Karpjenko, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, celular: (+33 671 152911).

Adresa e MVZ të OSBE/ODIHR:

rr. Makedonija 9–11, kati i dytë
1000 Shkup

Tel: +389–2–320 4777 Fax: +389–2–320 4773

Email: office@odih.org.mk